HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË DHE AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM



Janar – Dhjetor 2022

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Liridona Ademaj

Prishtinë, nëntor 2023

“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!»

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

SHKURTESA DHE DEFINIME **5**
HYRJE **6**
ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË? **7**
LEGJISLACIONI **9**
PROCESI I AKREDITIMIT/RIAKREDITIMIT DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT **11**
GJETJET PËR VITIN 2022 ..... **13**

I. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NGA AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM **13**
II. VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC) **14**
Bilanci i Studentëve Aktiv 17

III. INSTITUCIONET QË KANË MARRË AKREDITIM DHE INSTITUCIONET QË NUK KANË MARRË AKREDITIM INSTITUCIONAL **18**
IV. PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË **19**
V. RIFUNKSIONALIZIMI I KOMISIONIT TË ANKESAVE **22**
VI. SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË **24**
Ankesat e Studentëve të IAL-ve në AKA 24
Funksionalizimi i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim 24
Paditë e Institucioneve të Arsimit të Lartë Ndaj Agjencisë së Kosovës për Akreditim 25
Mungesa e Stafit në Agjenci 26
Mungesa e Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë 27
Mungesa e Analizës së Nevojave të Tregut të Punës 28
Mungesa e Shkëmbimit të Informatave për Stafin Akademik në Nivel Rajonal 28

VII. RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN **29**
PËRFUNDIME **30**

SHKURTESA DHE DEFINIME

AKA, Agjencia e Kosovës për Akreditim, është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit

KShC, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, është organ politikbërës dhe vendimmarrës i AKA-së, i cili përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve duhet të jenë ndërkombëtarë

IAL, Institucion i Arsimit të Lartë

Akreditim, Njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuara të cilësisë, përmes të cilit përcaktohet statusi zyrtar i institucionit të arsimit të lartë dhe programeve të tij të studimit për një periudhë kohore

ENQA, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

EQAR, Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

Bartës, Çdo institucion i themeluar ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë

Bartës publik, Bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Program, Program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë

Komision i Ankesave, Organi i cili trajton dhe shqyrton ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të KShC-së, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë

MAShTI, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

HYRJE

Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë gjatë vitit 2022 kanë arritur të marrin statusin anëtarë i asocuar në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe po vazhdojnë përpjekjet për rikthim në anëtarësi me të drejta të plota ngjashëm edhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Gjatë vitit 2022, AKA dhe KSHC kanë punuar në plotësimin e rekomandimeve që i kontribuojnë cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë tek të gjithë hisedarët dhe gjendja e arsimit në vendin tonë në përgjithësi por edhe në pozitën e kësaj agjencie në institucione të rëndësishme si ENQA dhe EQAR.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2022. ORCA ka qenë e pranishme si monitoruese në mbledhjet e mbajtura nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, përmes të cilave është informuar për të gjitha zhvillimet dhe vështirësitë me të cilat ata janë përballur gjatë punës së tyre. Raporti përmban të dhëna rreth vendimeve të KSHC-së për akreditim, riakreditim apo mosakreditim të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore, të ndara në kategori sipas llojit të institucioneve dhe nivelit të programeve. Tutje është trajtuar edhe puna e AKA-së dhe veprimet e tyre për sigurimin e cilësisë, puna e Komisionit të Ankesa e shumë të tjera.

Hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, është njëra ndër mënyrat më efikase për sigurimin e pavarësisë së plotë në vendimmarrje të këtij institucioni, konkretisht për akreditimin e institucioneve dhe programeve. Kjo do ta pamundësojë ndikimin e politikave të dëmshme momentale të ministrave të arsimit në detyrë apo zyrtarëve të tjerë të lartë publik të cilat cenojnë pavarësinë e AKA-së në vendimmarrje.

ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË?

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Ajo është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton standardet dhe harton procedurat për sigurimin e cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë.

AKA përbëhet nga bordi i saj, i njohur si Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), i cili është organ politikbërës dhe vendimmarrës, si dhe nga një strukturë e përhershme administrative e agjencisë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) punon duke u bazuar në *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë*. KShC merr vendim për akreditim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet, por asnjë vendim i KShC-së për akreditim/riakreditim nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë përbëhej nga shtatë anëtarë, Hasnije Ilazi, Dukagjin Zeka, Rozafa Koliqi, Krenare Pireva-Nuçi, Gëzim Tosuni, Seb Bytyçi , si dhe një anëtarë ndërkombëtarë, Klemen Miklaviç[1]. KShC është institucioni që merret me akreditimin e IAL-ve publike dhe private që ofrojnë studime të nivelit akademik me kredi (ECTS).

Komisioni i Ankesave është organ i cili trajton dhe shqyrton ankesat e parashtruara të palëve të ndryshme ndaj vendimeve të KShC-së. Ai për-

1 Këshilli Shtetëror i Cilësisë në kohën e botimit të këtij raporti përbëhet nga pesë anëtarë, Hasnije Ilazi, Gëzim Tosuni, si dhe anëtarët ndërkombëtarë, Klemen Miklaviç, Maja Martinoviç dhe Jaakko Kauko.

bëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë, aktualisht anëtarë të përhershëm janë Ibish Mazreku i cili është edhe kryetar dhe Zejnepe Imeri, si dhe dy anëtarët rezervë Kemajl Zeqiri dhe Fatos Rexhepi.

Ky komision punon duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë (UA 15/2018).

LEGJISLACIONI

Në janar të vitit 2022[2], Komisioni parlamentar për Arsim kishte miratuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i cili e rregullon statusin e Agjencisë si agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit.

Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria e Kosovës kishte propozuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim[3] të cilin e kishte shpërndarë tek deputetët, si dhe e kishte publikuar në ueb faqen zyrtare të Kuvendit për të vazhduar me procedurat e nevojshme. Ky projektligj ka kaluar shqyrtimin e parë në mbledhje plenare të Kuvendit dhe është duke vazhduar në fazat e tjera të parapara.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), vepron duke u bazuar në *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*[4], konkretisht me Nenin 7 '*Agjencia e Kosovës për Akreditim'*, në të cilin sqarohet se AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, andaj edhe siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

AKA është përgjegjëse për inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë e Arsimit lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave, kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, vlerësimin periodik të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar, si dhe shpalljen e politikave, kritereve dhe standardeve për akreditim. *Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e In-*

2 Lajm/ Miratohet projektligji për i hap rrugë Agjencisë së Akreditimit për kthim në ENQA dhe EQAR, 25 janar 2022, linku: https://www.koha.net/arberi/307639/miratohet-projektligji-qe-i-hap-rruge-agjencise-se-akreditimit-per-kthim-ne-enqa-dhe-eqar/

3 Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, dhjetor 2021, linku: https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=348#info-div

4 Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2011, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761

stitucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës[5], përcakton kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

AKA funksionon edhe me *Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)*[6], përmes të cilës përcaktohet funksionimi, përbërja, mënyra e marrjes së vendimeve, detyrat dhe mënyra e punës së këtij këshilli. Në Nenin 7 të kësaj rregulloreje, *'Përgjegjësitë dhe funksionet e KShC-së'*, thuhet se KShC përcakton objektivat kryesore dhe afatet kohore të procesit të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), miraton Standardet, Procedurat dhe Kriteret e vlerësimit të jashtëm të IAL-ve të hartuara nga AKA.

Ky këshill, gjithashtu harton dhe miraton statutin e AKA-së, rregulloret dhe dokumentet tjera të nevojshme për funksionimin e Agjencisë.

Në *'Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave'*[7], përcaktohen rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave, si dhe rregullohet puna, organizimi dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave. Neni 4 i kësaj rregullore, *'E drejta e ankesës'*, sqaron se palët mund të paraqesin ankesë nëse vendimi është marrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimit të KShC-së, në rast të zbatimit të gabuar të ligjit material apo rregullave materiale të zbatueshme dhe nëse vendimi nuk bazohet në faktet dhe provat e prezantuara.

Në *Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e institucioneve të Arsimit të lartë*[8], në Nenin 2, është shtuar para-

5 Udhëzimi Administrativ nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2018, linku: https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-nr-15-2018-per-akreditimin-e-institucioneve-te-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-kosoves/

6 Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), qershor 2018, linku: https://drive.google.com/file/d/1eRBWnoiUghGYcsp8nO5HlmVWlDUyQ3Te/view

7 Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave, 2019, linku: https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/11/Rregullore-mbi-punen-e-KA.pdf

8 Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, gusht 2019, linku: https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18/

grafi ku thuhet se IAL-ve të cilave u është refuzuar apo tërhequr akreditimi institucional apo i programeve të studimit, mund të aplikojnë përsëri brenda periudhës prej 90 ditëve nga pranimi i vendimit përfundimtar. Gjithashtu i është lejuar AKA-së, që të verifikojë të dhënat e paraqitura nga IAL-ët në çdo kohë, pa qenë nevoja që IAL-ët të jenë në proces vlerësimi për akreditim ose riakreditim.

Ndërkohë që edhe në *Udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë*[9], ishte shtuar se stafi akademik i cili është i deklaruar brenda një institucioni sipas afateve ligjore edhe ata të cilët nuk janë deklaruar në asnjë IAL, kanë të drejtën e riaplikimit në programe apo IAL të ndryshme në afat prej 90 ditësh pas marrjes së vendimit përfundimtar refuzues për një program të caktuar.

PROCESI I AKREDITIMIT/RIAKREDITIMIT DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT

Akreditimi mund të bëhet në nivelin e institucionit të arsimit të lartë, programit të studimit, degës dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në atë degë dhe njohjes së akreditimit valid ndërkombëtar. Kërkesën për akreditim mund ta bëj vet institucioni i arsimit të lartë, për nivelin e institucionit dhe programeve të tij të studimit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në raste specifike.

Akreditimit fillestar i nënshtrohet secili institucion, i cili pretendon të ofrojë arsim të lartë në Kosovë, ndërkohë që riakreditimit, i nënshtrohen institucionet e akredituara të arsimit të lartë në baza periodike.
Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), i cili aplikon për akreditim/riakreditim, duhet të dorëzojë kërkesën për akreditim bashkë me listat e stafit akademik, për të cilat KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program studimi.

9 Udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, korrik 2019, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf

Nëse vlerësimi preliminar nga KShC është pozitiv, nënkuptohet se aplikacioni i plotëson kushtet formale sipas akteve juridike në fuqi duke autorizuar drejtorin e AKA-së, për zhvillim të procedurave për procesin e vlerësimit dhe akreditimit. Ndërkaq nëse vlerësimi preliminar është negativ dhe KShC konstaton se aplikacioni ka mangësi dhe nuk i plotëson kushtet formale, atëherë KShC merr vendim për refuzim të aplikacionit.

Pas aprovimit të listës së stafit akademik dhe aplikacionit, AKA pranon një raport të vetëvlerësimit nga institucioni përkatës, të cilin pastaj do t'ia përcjellë ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë. Ky ekip shkruan një raport të jashtëm të vlerësimit të cilësisë së institucionit aplikues apo të programeve të tij të studimit, duke u bazuar në standardet dhe udhëzuesit për akreditim, në të cilin ofrohet edhe rekomandimi final për riakreditim apo mosakreditim. Pas vlerësimit të këtij raporti, KShC vendosë për akreditim/riakreditim apo ta refuzojë.

AKA-së i lejohet trajtimi i këtyre aplikacioneve në periudhë prej një viti, prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim ndërkaq kërkohet që këto aplikacione, të dorëzohen në Agjenci më së largu me 31 tetor.

Akreditimi institucional fillestar është për tri vite dhe riakreditimi jo më shumë se pesë vite, përveç rasteve kur ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër e cila merr pajtimin e bordit të KShC-së. Ndërkohë, kohëzgjatja e riakreditimit të programit studimor, është tri deri në pesë vite, pos rasteve me rekomandim ndryshe.

AKA mund ta tërheq vendimin e saj për akreditim në çfarëdo kohe, nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur, nëse aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumente të rreme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit, si dhe nëse raporti i monitorimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë konstaton se rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm nuk janë zbatuar dhe gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë.
Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat e parashtruara nga IAL-ët kundër vendimeve të KShC-së dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të tyre.

I. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NGA AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM

Agjencia e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2022 kishte shqyrtuar gjithsej 14 aplikacione për akreditim apo riakreditim institucional dhe 119 aplikacione për akreditim apo riakreditim të programeve.

Procesi i vlerësimit është zhvilluar fizikisht nga ekspertët dhe në çdo vizitë në institucionet e arsimit të lartë kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të agjencisë. Në procesin e vlerësimit të institucioneve kanë qenë të angazhuar 74 ekspertë të akreditimit të cilët i kanë realizuar gjithsej 83 vizita në IAL dhe degë të IAL-ve të ndryshme.

Në vizitat në IAL, përfaqësues të agjencisë dhe ekipi i ekspertëve kanë zhvilluar takime me menaxhmentin e institucionit, me zyrtarë për sigurim të cilësisë, me kryesues të programeve studimore si dhe me staf mësimdhënës. Po ashtu, takim ka pasur edhe me studentë, të diplomuar dhe me disa punëdhënës të të diplomuarve.

Pas këtyre takimeve, ka pasur një takim të brendshëm me vetëm ekipin e ekspertëve dhe AKA-në. Vizita ka përfunduar me një takim përmbyllës me menaxhmentin e institucionit. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë i kanë marrë në shqyrtim të gjitha materialet, përfshirë edhe raportet e vetëvlerësimit, kanë kërkuar dokumente shtesë dhe më pas kanë dorëzuar draft raportin. Pas adresimit të komenteve në raport, ekspertët në fund kanë dorëzuar raportin përfundimtar.

II. VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC)

Në proces të akreditimit institucional gjatë vitit 2022, kanë qenë gjithsej 14 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), ku prej tyre 13 ishin private dhe 1 ishte publike. 12 IAL kanë marrë akreditim institucional, ndërkaq 2 janë refuzuar. Të gjitha IAL të refuzuar në vitin 2022 janë private. Në këtë proces, dy kolegje private kanë dështuar në akreditimin institucional.

14 Aplikime për akreditim institucional në 2022




Prej 12 aplikacioneve për riakreditim institucional, 7 janë nga institucionet private dhe 5 nga institucionet publike.

Ndërkaq për krahasim, në vitin 2021 me akreditim institucional ishin bërë 2 IAL publike dhe 5 IAL private, ndërsa pa akreditim institucional gjatë atij viti, ishin 4 IAL private.

Në vitin 2022, nga 119 aplikacione për akreditim/riakreditim, 64 programe janë të IAL-ve private dhe 55 të IAL-ve publike.

119 Aplikime për akreditim të programeve studimore në 2022




54% Akredituar

46% të pa akredituar

Nga 119, 64 programe studimore janë aprovuar për akreditim, prej tyre 38 në IAL publike dhe 26 në IAL private.

Ndërkaq 55 nuk janë aprovuar, ku 47 janë refuzuar në fazën e aplikimit prej të cilave 32 janë private dhe 15 publike, kurse prej 8 që nuk janë riakredituar, janë 5 private dhe 3 publike.


Përqindja e suksesit në akreditim të programit studimor 2022 - IAL publike



Pozitiv 72%

Negativ 28%

Përqindja e suksesit në akreditim të programit studimor 2022 - IAL private



Pozitiv 55%

Negativ 45%

Përqindja e aprovimit për akreditim të programeve studimore është shumë më e ulët tek institucionet private të arsimit të lartë. Kjo mund të jetë për arsyet në vijim që i ka observuar ORCA: numri i programeve të reja është më i madh tek këto IAL se sa tek ato publike; kontratat e bartësve të propozuar nga IAL-ët private nuk janë nënshkruar me kohë, bartësit e propozuar nuk kanë thirrjen e duhur profesoriale, dhe mund të mos jenë të fushës së ngushtë apo të mos kenë publikimet e nevojshme shkencore në platformat e kërkuara. Dy arsyet e fundit vlejnë edhe për IAL publike.

Gjatë vitit 2022, janë dhënë gjithsej 9 vendime negative për akreditim të programeve në Institucione të Arsimit të Lartë (IAL) publik dhe privat. 7 prej tyre janë dhënë për programe të IAL-ve publike dhe 2 të tjera për programe të IAL-ve private.

Për krahasim, gjatë vitit 2021 ishin dhënë 35 vendime negative nga KShC për akreditim të programeve dhe institucioneve, ku prej tyre 4 vendime ishin për akreditim institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) privat, 15 vendime ishin për programe prej Institucioneve të Arsimit të Lartë privat, si dhe 16 vendime ishin për programe prej Institucioneve të Arsimit të Lartë publik.


Numri i programeve të akredituara në institucione publike gjatë vitit 2022 ishte 224, ndërsa numri i programeve të akredituara në institucione private gjatë vitit 2022 ishte 165.

Numri i programeve të akredituara në institucione publike gjatë vitit 2021 ishte 226, ndërsa numri i programeve të akredituara në institucione private gjatë vitit 2021 ishte 177.

Numri i programeve të akredituara në institucione publike gjatë vitit 2020 ishte 234, ndërsa numri i programeve të akredituara në institucione private gjatë vitit 2020 ishte 128.

Numri i programeve të akredituara në institucione publike gjatë vitit 2019 ishte 172, ndërsa numri i programeve të akredituara në institucione private gjatë vitit 2019 ishte 120.

Numri i programeve me akreditim sipas viteve



Bilanci i Studentëve Aktiv

Numri i përgjithshëm i studentëve në universitete publike gjatë vitit 2022[10], ishte 40 mijë e 996 (*në vitin 2021 ishte 50 mijë e 188*[11]), ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve në kolegje private ishte 30 mijë e 952 (*në vitin 2021 ishte 32 mijë e 201*).

Nga këto të dhëna rezulton se universitetet publike kishin 10 mijë e 44 studentë më shumë se kolegjet private në të gjitha nivelet e studimit që ofrojnë këto institucione të arsimit të lartë.

Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës "*Statistikat e arsimit të lartë sipas fushave të studimit*" për vitin akademik 2022/2023[12], rezulton se numri i përgjithshëm i studentëve të cilët ndjekin studimet në nivelin Bachelor në universitete publike dhe kolegje private i përkasin fushës "Biznes, Administratë dhe Ligj" me gjithsej 16 mijë e 877 studentë. Më pas vjen fusha "Shëndeti dhe mirëqenia" me 9 mijë e 555 studentë.

Ndërkaq numri i përgjithshëm i studentëve të cilët ndjekin studimet në nivelin Master në universitete publike dhe kolegje private i përkasin fushës "Biznes, Administratë dhe Ligj" me gjithsej 3 mijë e 853 studentë. Më pas vjen fusha "Inxhinieri, prodhimi dhe ndërtimi" me 1 mijë e 273 studentë.

10 Raporti "Statistikat e arsimit në Kosovë 2022/23" i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, fq.76, linku: https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimitne-kosove-2022-2023/

11 Raporti "Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/22" i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, fq.74, linku: https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/

12 Raporti "Statistikat e arsimit të lartë sipas fushave të studimit 2022/2023", fq. 5, linku: https://askapi.rks-gov.net/Custom/dcc09a63-5933-4f73-9af1-7c4033154f64.pdf


III. INSTITUCIONET QË KANË MARRË AKREDITIM DHE INSTITUCIONET QË NUK KANË MARRË AKREDITIM INSTITUCIONAL

INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË	
Me akreditim: • Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" • Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" • Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" • Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" • Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj • Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" • Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" • Akademia e Kosovës për Siguri Publike • Fakulteti i Studimeve Islame	**Pa akreditim:**
INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË	
Me akreditim: • Kolegji AAB • AUK • Kolegji Biznesi • Kolegji ESLG • Akademia Evolucion • International Business College Mitrovica (IBC-M) • Kolegji Heimerer • Kolegji "Pjetër Budi" • Kolegji Rezonanca • Kolegji Riinvest • Tempulli Academy (Kolegji Tempulli) • Kolegji UBT • Kolegji Universum	**Pa akreditim:** • Kolegji Fama • AAB-Riinvest • Kolegji Cacttus Education • Kolegji Globus • Kolegji Dardania • Kolegji Iliria • Kolegji ISPE • Kosovo Art Academy • Kolegji Dukagjini • Kolegji Universi • Kolegji Arbëri

IV. PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2022 në Institucione të Arsimit të Lartë është 389. Programet e akredituara në IAL publike janë 224, ndërsa në IAL private janë 165.


389 programet studimore me akreditim në 2022



Për krahasim, numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2021 në IAL publike ishte 226, ndërsa në IAL private ishte 177.

Nga të dhënat e siguruara për vitin 2022 rezulton se top 5 institucionet me numër më të madh të programeve të akredituara janë Universiteti i Prishtinës me 138 (50% e totalit) , Kolegji UBT me 53 (19%), AAB me 50 (18%), Universiteti i Mitrovicës me 18 (7%) dhe Universiteti i Pejës me 17 (6%).

Top 5 IAL-të me më së shumti programe të akredituara në 2022




Programet Studimore në Institucione Publike të Arsimit Të Lartë

Në 2022, në universitetet publike në Kosovë të akredituar janë gjithsej 224 programe nga niveli Baçelor, Master, Doktor dhe Doktor i Shkencës.

Universiteti i Prishtinës ka më së shumti programe studimore duke numëruar gjithsej 138 programe, Universiteti i Mitrovicës ka 18 programe studimore, më pas Universiteti i Pejës ka 17 programe, Universiteti i Prizrenit numëron gjithsej 14 programe studimore, Universiteti i Ferizajt ka 13 programe, tutje Universiteti i Gjilanit ka gjithsej 11 programe studimore, Universiteti i Gjakovës ka 9 programe studimore, ndërsa Fakulteti i Studimeve Islame ka gjithsej 3 programe kurse Fakulteti i Sigurisë Publike ka vetëm një program studimor.

Përqindja e programeve studimore në IAL publike në vitin 2022



Pra në vitin 2022 Universiteti i Prishtinës prinë me 62% të programeve të akredituara në institucione publike të arsimit të lartë, dhe me 50% të të gjitha programeve të akredituara në IAL publike dhe private bashkë.

Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, në IAL publike kanë qenë të akredituara gjithsej 226 programe të niveleve të ndryshme të studimit. Pra gjatë vitit 2022, kanë pasur akreditim 2 programe më pak se sa në vitin 2021.

Universiteti i Prishtinës prinë për numrin e programeve të akredituara që nga matja e parë e ORCA-s (156 në vitin akademik 20/21, 136 në vitin akademik 21/22, dhe 138 në vitin akademik 22/23.)


Programet Studimore në Institucione Private të Arsimit Të Lartë

Në 2022, në kolegjet private në Kosovë janë akredituar gjithsej 165 programe në nivele të ndryshme studimi si Baçelor, Master dhe doktor të mjekësisë.

Kolegji UBT ka më së shumti programe duke numëruar gjithsej 53, Kolegji AAB ka 50 programe studimore, Kolegji Universum tutje numëron gjithsej 16 programe studimore, Kolegji Rezonanca ka 10 programe, Kolegji Heimerer ka 7 programe studimore, Kolegji Biznesi ka 6 programe, Kolegji IBCM ka gjithsej 6 programe studimore, Kolegji RiInvest ka 4 programe, Kolegji RIT

(AUK) ka 3 programe studimore, Akademia Evolucion ka 3 programe studimore, Akademia Tempulli ka gjithsej 3 programe, Kolegji ESLG ka 2 programe studimore dhe Kolegji Pjetër Budi ka gjithsej 2 programe.

Përqindja e programeve studimore në IAL private në vitin 2022



Në vitin 2022 Kolegji UBT prinë me 32% të programeve të akreditauara nga institucionet private të arsimit të lartë dhe vetëm 8% të programeve nga të gjitha IAL publike dhe private bashkë.

Për krahasim, në vitin 2021 numri i programeve në nivele të ndryshme studimi ishte 177. Pra gjatë vitit 2022, numri i programeve të akredituara është zbritur për 12 programe më pak.

Institucioni privat i arsimit të lartë i cili ka më së shumti programe të akredituara në vitin akademik 2022/2023 është Kolegji UBT me 53 programe nga nivele të ndryshme studimi.

Institucioni privat i arsimit të lartë i cili ka më së shumti programe të akredituara në vitin akademik 2021/2022 është Kolegji UBT me 54 programe nga nivele të ndryshme studimi.

Institucioni privat i arsimit të lartë i cili ka më së shumti programe të akredituara në vitin akademik 2020/2021 është Kolegji AAB me 48 programe nga nivele të ndryshme studimi.

V. RIFUNKSIONALIZIMI I KOMISIONIT TË ANKESAVE

Në tetor të vitit 2022, Komisioni i Ankesave në Agjenci të Kosovës për Akreditim kishte filluar përsëri me punën e saj pas përzgjedhjes dhe emërimit të katër anëtarëve të rinj dhe që nga kjo kohë ky komision kishte filluar me trajtimin e ankesave që i ishin dërguar kësaj trupe.

Aktualisht ky komision ka dy anëtarë të përhershëm dhe dy rezervë. Kryetar i Komisionit është Ibish Mazreku ndërsa anëtare e përhershme është Zejnepe Imeri. Anëtarët rezervë të Komisionit të Ankesave janë Kemajl Zeqiri dhe Fatos Rexhepi.

Kujtojmë që në nëntor të vitit 2021, kryetari i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për arsye personale, prandaj që nga ajo kohë ky komision kishte mbetur jashtë funksionit të tij meqenëse më herët ishte dorëhequr edhe një anëtare për shkak të emërimit në një pozitë publike, ky komision kishte mbetur me vetëm një anëtar të përhershëm dhe një rezervë. Komisioni ishte themeluar në shtator të vitit 2020, Agjencia për Akreditim kishte emëruar pesë anëtarë në këtë Komision të Ankesave[13].

13 Lajm/Themelohet Komisioni i Ankesave i Agjencisë së Akreditimit, shtator 2020, linku: https://kallxo.com/lajm/dokument-themelohet-komisioni-i-ankesave-i-agjencise-se-akreditimit/

VI. SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË

Ankesat e Studentëve të IAL-ve në AKA

Sipas stafit të AKA-së, gjatë vitit 2022 kanë pranuar gjithsej tetë ankesa nga studentë të Institucioneve të Arsimit të Lartë privat e publik në sistemin për paraqitje të ankesave për të raportuar për probleme të ndryshme brenda institucioneve ku janë duke i kryer studimet apo që i kanë përfunduar ato.

Gjashtë ankesa ishin për kolegje ndërsa dy ankesa për universitete publike. Tri ankesa kishin të bëjnë me Kolegjin Universum, një ankesë për Kolegjin Heimerer, një tjetër për Kolegjin FAMA dhe e fundit për Kolegjin Dardania. Ndërkaq një ankesë ishte për Fakultetin e Edukimit në Universitet të Prishtinës dhe një ankesë për Universitetin e Mitrovicës.

Funksionalizimi i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Njëra ndër 13 rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte edhe krijimi i një ligji i cili rregullon punën dhe funksionimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, por që në të njëjtën kohë e siguron pavarësinë e saj dhe zbatimin e standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Në janar të vitit 2022[14], Komisioni parlamentar për Arsim kishte miratuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i cili e rregullon statusin e Agjencisë si agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit. [15]

14 Lajm/ Miratohet projektligji për i hap rrugë Agjencisë së Akreditimit për kthim në ENQA dhe EQAR, 25 janar 2022, linku: https://www.koha.net/arberi/307639/miratohet-projektligji-qe-i-hap-rruge-agjencise-se-akreditimit-per-kthim-ne-enqa-dhe-eqar/

15 Në kohën kur ky raport është botuar, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim është miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi.

Paditë e Institucioneve të Arsimit të Lartë Ndaj Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Përgjatë vitit 2022, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka pranuar gjithsej tri padi nga Institucione të Arsimit të Lartë privat, konkretisht nga Kolegji Iliria, Kolegji Universum dhe Kolegji FAMA në të cilat AKA është përgjigjur duke ofruar dëshmitë e saj rreth proceseve të caktuara të cilat janë atakuar nga kolegjet në fjalë.

Kolegji Iliria kishte paditur AKA-në duke kërkuar që të anulohet vendimi i KSHC-së i cili nuk i kishte dhënë akreditim institucional këtij kolegji.

Kolegji Universum kishte paditur AKA-në duke kërkuar që të anulohet vendimi i KSHC-së i cili kishte refuzuar kërkesën për akreditim/riakreditim të katër programeve.

Kolegji FAMA kishte paditur AKA-në duke kërkuar që të anulohen vendimet e KSHC-së në të cilat ishte vendosur për tërheqje të akreditimit për disa programe dhe refuzim të kërkesës për akreditimin e disa programeve të tjera. Këto padi nuk kanë përfunduar ende si procese gjyqësore.

Ndërkaq, janë pesë raste të tjera të padive të cilat janë shqyrtuar nga gjykata gjatë vitit 2022 por që jo domosdoshmërisht janë iniciuar gjatë këtij viti, prej të cilave në tri prej tyre paditësit janë tërhequr, një është refuzuar si e pabazuar dhe në njërën pala paditëse është shpallë fajtore.

> Universiteti i Mitrovicës kishte paditur AKA-në lidhur me vendimin e KSHC-së për mos riakreditim institucional por që ishte tërhequr nga padia.
>
> Universiteti i Prishtinës kishte paditur AKA-në lidhur me kërkesën për anulimin e një vendimi të Komisionit të Ankesave mirëpo që rasti ishte pezulluar nga Gjykata.
>
> Kolegji ISPE kishte paditur dy ish zyrtarë të AKA-së për shpifje dhe kompensim dëmi mirëpo që ndërkohë ishte tërhequr nga padia.

Tutje Fakulteti i Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës kishte paditur AKA-në për vendimin në të cilin sipas tyre kishin ndërruar emrin e një programi, numrin e studentëve të lejuar për regjistrim dhe kohëzgjatjen e akreditimit por kjo ishte refuzuar nga gjykata si e pabazuar.

AKA kishte paditur pronarin e Kolegjit ISPE për legalizim të përmbajtjes së rreme meqenëse kishte dorëzuar konfirmimin e rremë për pagesën për hyrje në proces të akreditimit për çka gjykata e kishte shpallë fajtor.

Për krahasim, gjatë vitit 2021 Agjencia e Kosovës për Akreditim kishte pranuar gjithsej 12 padi nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë publik e privat, të cilat ishin iniciuar gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Në këto padi, të gjitha rastet ishin fituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

AKA nuk publikon informacione për llojin dhe përmbajtjen e padive.

Mungesa e Stafit në Agjenci

Agjencia gjatë vitit 2022 e ka rritur numrin e zyrtarëve të punësuar në 11, gjithashtu ka punësuar edhe tri zyrtare praktikante me të cilat numri i zyrtarëve ka arritur në 14.
Sipas *Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022*[16], Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i është ndarë buxheti për 32 pozita, ngjashëm me buxhetin e vitit 2021.

Vështirësitë administrative në proces të rekrutimit publik, kriteret, cilësia e shqyrtimit të lëndëve, objekti në të cilin janë vendosur e shumë të tjera, kanë bërë që AKA të mos mund ta kompletojë stafin e nevojshëm, e për pasojë ende nuk kanë arritur të bëjnë monitorimin e IAL-ve.

16 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51763

Si pasojë e mungesës së stafit, AKA deri më tani ka shqyrtuar kriteret minimale për akreditimin e programeve studimore dhe akreditimin institucional. Pra bëhet rishikimi i numrit profesor-studentë, sasia e pajisjeve, si dhe hapësira e objektit të IAL-ve.

Ndërkohë që kompetencë e AKA-së është edhe shqyrtimi i kërkimit shkencor të institucioneve, i politikave për zhvillimin e stafit akademik, i organizimit të brendshëm dhe qasjes së IAL-ve ndaj sigurimit të cilësisë, i monitorimit të progresit të studentëve e shumë të tjera.

Mungesa e Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë

Njëra ndër rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte miratimi dhe funksionalizimi i Metodologjisë së Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë. Pas emërimit të anëtarëve të ri të bordit dhe drejtorit të Agjencisë, ky dokument ishte aprovuar në shkurt të vitit 2022.

Pavarësisht aprovimit të këtij dokumenti, Agjencia e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2022 nuk ka bërë monitorimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe mungesa e monitorimit të mirëfilltë nga AKA-ja ndaj institucioneve të cilave i ka dhënë akreditim, ka qenë evidente ndër vite.

Metodologjia e monitorimit plotëson Standardin 2.3 të Udhëzuesve Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG), i cili kërkon që agjencitë e sigurimit të cilësisë të përmbyllin ciklin e akreditimit me procedura pasakrediuese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Monitorimi është proces formal që duhet kryer nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), përmes të cilit verifikohet nëse institucionet e arsimit të lartë po e vazhdojnë plotësimin e rekomandimeve të ekspertëve të jashtëm dhe po i mirëmbajnë kushtet me të cilat janë akredituar.

Mungesa e monitorimit të IAL-ve deri tani ka shkaktuar probleme të ndryshme veçanërisht për studentët. Për pasojë ishte rritur numri i stu-

dentëve që kishin diplomuar në programe pa akreditim, që ishin pjesë e numrit të tejkaluar të kuotave të studentëve për programe të ndryshme studimore andaj nuk arrinin të bënin validimin e diplomave të tyre në Qendrën Kombëtare për Njohje të Diplomave, studentët kishin vijuar studimet në një program dhe kishin marrë diplomë nga një program tjetër e shumë parregullsi të tjera.

Mungesa e Analizës së Nevojave të Tregut të Punës

Nuk ka ende ndonjë analizë të përpiluar nga ana e Ministrisë së Arsimit[17], Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve[18], Agjencisë së Kosovës për Akreditim[19], Agjencisë së Statistikave të Kosovës[20] dhe Agjencisë së Punësimit[21], e cila tregon dhe shpërfaq nevojat e tregut të punës në Kosovë.

Ky lloj i informatave do të mund të publikohej në faqen zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes të cilës të interesuarit për studime universitare, do të informoheshin dhe orientoheshin për programet të cilat i nevojiten tregut të punës. Si dhe do të shërbente si udhërrëfyes për Këshillin Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të marrjes së vendimit për akreditimin e programeve studimore.

Mungesa e Shkëmbimit të Informatave për Stafin Akademik në Nivel Rajonal

Është e nevojshme një databazë, e cila do të shërbente për informimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, brenda dhe jashtë vendit, për përbërjen e stafit akademik në institucionet e akredituara, në mënyrë që t'u pamundësohet profesorëve që të angazhohen si staf i rregullt, në më shumë se një institucion të arsimit të lartë në shtete të ndryshme.

17 Faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Republikën e Kosovës, linku: https://masht.rks-gov.net/

18 Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në Republikën e Kosovës, linku: https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1

19 Faqja zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, linku: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/

20 Faqja zyrtare e Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, linku: https://ask.rks-gov.net/

21 Faqja zyrtare e Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, linku: https://aprk.rks-gov.net/

VII. RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

Në tetor të vitit 2022, ishte publikuar Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën[22], në të cilin përsëri ishte trajtuar progresi dhe mangësitë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Në këtë raport është cekur përsëri se Agjencia e Kosovës për Akreditim është duke vazhduar me përpjekjet për të rifituar anëtarësinë e plotë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Tutje është rekomanduar që të miratohet Ligji për Agjencinë e Akreditimit nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të rritet pavarësia operacionale dhe transparenca në emërimin e menaxhmentit në AKA. Draftligji i ri, sipas këtij raporti, adreson çështjen e deklarimit të pasurisë nga anëtarët ndërkombëtarë të bordit të AKA-së të cilët i shtynte drejtë dorëheqjes nga këto pozita.

Është shkruar se rekomandimet e vitit të kaluar ishin plotësuar pjesërisht dhe se në vitin që vjen Kosova duhet të aplikojë sistematikisht mekanizma të sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e edukimit, veçanërisht në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional, në fushën e arsimit të lartë dhe të vazhdohet me procedurat e monitorimit pas akreditimit të programeve.

22 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2022, fq. 103-105, linku: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf

PËRFUNDIME

Monitorimi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, është njëra ndër komponentët më të rëndësishëm të kësaj agjencie e cila edhe gjatë vitit 2022 nuk ka arritur të zbatohet. Mungesa e saj vazhdon të lejë hapësirë për mashtrimin e studentëve nga shumë prej institucioneve të arsimit të lartë që operojnë në vendin tonë. Përmes monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë mund të arrihet parandalimi i lajthitjes së studentëve dhe marrja e masave ndaj atyre institucioneve që i tejkalojnë apo i thyejnë kushtet përmes të cilave kanë marrë akreditimin institucional apo për programe.

Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2022 në Institucione të Arsimit të Lartë ishte 389. Programet e akredituara në IAL publike ishin 224, ndërsa në IAL private ishin 165.

Për vitin 2022, rezulton se top 5 institucionet me numër më të madh të programeve të akredituara janë Universiteti i Prishtinës me 138 (50% e totalit) , Kolegji UBT me 53 (19%), AAB me 50 (18%), Universiteti i Mitrovicës me 18 (7%) dhe Universiteti i Pejës me 17 (6%).

Është shumë e rëndësishme që të vazhdojë ngritja e kritereve dhe standardeve për akreditim në mënyrë që diplomat e studentëve të iu sigurojnë atyre një të ardhme më të mirë.

Edhe gjatë vitit 2022, ka munguar hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në mënyrë që procesi i akreditimit të pavarësohet nga ndikimet e tërthorta të ministrave të ndryshëm të arsimit përmes udhëzimeve administrative.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë ishte kompletuar me dy anëtarë ndërkombëtarë gjatë vitit 2022, përmes të cilëve të gjitha vendimet konsiderohen legjitime mirëpo ky bord duhet përqendruar në krijimin e politikave të mëtutjeshme, në mënyrë që arsimi i lartë në Republikën e Kosovës të jetë i bazuar në nevojat e tregut të punës dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë që të diplomuarit të përgatiten me aftësitë e nevojshme për punë.

Agjencia e Kosovës për Akreditim e ka të domosdoshme rekrutimin e të gjithë stafit të nevojshëm për proceset administrative të cilat kryhen nga kjo e fundit.

Në tetor të vitit 2022, kjo agjenci mori statusin e asocuar nga Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EAQA/ENQA) mirëpo pritet që në të ardhmen të pranojnë vendimin e ri pas vlerësimit për rianëtarësim të plotë, gjithashtu edhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). E për të arritur rianëtarësimin në këto dy institucione të rëndësishme për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe arsimin e lartë në përgjithësi, duhet vazhduar përpjekjet për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes vendimmarrjes nga instancat relevante dhe për parandalimin e çfarëdo presioni apo ndikimi të jashtëm e politik që padyshim do ta dëmtojë këtë proces.

E rëndësisë jetike është edhe bashkëpunimi i kësaj agjencie me institucionet relevante, për të bërë hulumtimin e tregut të punës, në mënyrë që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të bazohet në atë studim kur trajton apo shqyrton aplikimet për akreditim të programeve studimore nga institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë. Kjo padyshim që do t'iu shërbente studentëve por edhe vendit tonë drejtë rrugës së duhur dhe plotësimit të nevojave të tregut të punës.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "*Intervenimi në Arsimin e Lartë – HEI'25*". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim